



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të**”, Nr. i prokurimit- 632-25-2137-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik **Roza Komani B.I., sh.p.k.**, e dt.30.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të**”, Nr. i prokurimit- 632-25-2137-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 19.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, të publikuar me datë: **19.03.2025;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik **Roza Komani B.I.**, me dt.01.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i Qendrës së Biznesit-faza-II-të**”, Nr. i prokurimit- 632-25-2137-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-028-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pabazuara sepse:

Në lidhje me pajisjet e specifikuara në **Aneksin 7 – Pajisjet dhe Mekanizmi i Nevojshëm:**

- **Makina për imtesimin ose ilustrimin e drurit (pika 11, minimumi 0.2 ton)**
- **Makina thithëse të grimcave të drurit (pika 12, minimumi 0.5 ton)**
- **Gyp për largimin e materialeve të demoluara (pika 13, 20 m)**

Këto pajisje janë të domosdoshme për realizimin e punëve që janë parashikuar në **PUNËT E ZDRUKHTARISË (pika 1.04)** dhe **PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLIMIT (pika 1)**, siç vijon:

1. **Makina për imtesimin e drurit dhe makina thithëse të grimcave të drurit janë të nevojshme për të realizuar punimet në kuadër të PUNËVE TË ZDRUKHTARISË (pika 1.04)**, ku kërkohet pastrimi dhe përpunimi i materialeve të drurit. Këto pajisje kontribuojnë në përmbushjen e kërkesave të cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të punimeve.
2. **Gypi për largimin e materialeve të demoluara (pika 13)** është i domosdoshëm për **PUNËT PARAPREGADITORE DHE DEMOLIMIT (pika 1)**, pasi ky mekanizëm lehtëson largimin e materialeve të dema, duke siguruar një menaxhim efikas dhe të sigurt të mbetjeve gjatë procesit të demolitimit dhe përgatitjes së terrenit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj
Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

